



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS
01.NR. _____
KLINË, 21.8. 2017

PROCEVERBAL
I SEANCËS SË VIII-të TË KK, MBAJTUR ME 21.8.2017, NË ORËN 10.00,
NË SALLËN E KK

Në seanca prezantuan: Kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK, drejtorë të drejtorive, Komandanti i Policisë në Klinë, Rexhë Berisha, KFOR-i, OSBE, Zyra Ligjore etj.

Keni marrë rendin e ditës, nëse rreth rendit të ditës dikush dëshiron të marrë fjalën. Nuk pati debat rreth rendit të ditës.

Vuri në miratim rendin e ditës.

Me vota unanime (16), pa kundër dhe pa abstenim u miratua

RENDI I DITËS

- 1. Arsyetimi i mungesave,**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi paraprak i buxhetit dhe projekteve të Komunës për vitin 2017,**
- 4. Shqyrtimi i propozimit për vendosje të panos së anëtarëve të Kuvendit Komunal në sallën e KK,**
- 5. Të ndryshme.**

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Haxhi Ibishi, tha se mungesat e anëtarëve janë pjesa dërmuese me arsye se kanë qenë në një planifikim të pushimit si hap kalendarik. “Ju e dini që ne kemi pasur edhe një arsye shtesë për ta mbajtur këtë seancë, ka qenë arsye për shqyrtim paraprak të buxhetit dhe projektet të Komunës së Klinës, prandaj e kemi thirrë e kemi parë të arsyeshme që duhet për të thirrur këtë seancë gjatë gushtit që të përgatitemi sa më mirë që në seancën e shtatorit me propozime konkrete për

buxhetin edhe për projektet, të cilat na vijnë si të këtilla për të pasur një dakordancë sa më të gjerë edhe politike në vendimmarrjen tonë si AK.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Haxhi Ibishi, the se procesverbali nuk ju ka ardhur për arsye se do t'ju japim për në seancën e shtatorit të përgatitur, edhe lejon ligji që të dy procesverbale t'i miratojmë pas një diskutimi në seancën e shtatorit.

Po bëj një digresion në pikat e rendit të ditës, këshilltarja Zefi dhe këshilltari Shabanaj, më kanë informuar paraprakisht që kanë nga një deklaratë që dëshirojnë për ta lexuar

Violeta Zefi, theksoi se rrugëtimin tim politik do ta vazhdoj në LDK, përkatësisht në Grupin e asamblistëve të LDK-së, njëkohësisht me këtë rast vetëm desha për t'i falënderuar të gjithë ata me të cilët kemi bashkëpunuar gjatë kësaj kohe, në veçanti me profesor Ndoun për bashkëpunimin dhe korrektësinë, edhe me këtë prezantim të shkurtër ju uroj të gjithëve atyre me të cilët kemi bashkëpunuar gjatë kësaj kohe. Suksese në punën e tyre edhe njëkohësisht edhe në jetën e tyre personale”, ka shtuar anëtarja Zef.

Haxhi Ibishi, falënderoj anëtarën Zefi.”Respekt i veçantë edhe për vendimin, që është krejtësisht legjitim. Për korrektësinë që keni treguar gjatë këtij mandati, ju personalisht bashkë me prof. Ndoun, për vendimet që kemi marrë bashkë dhe për të njëjtën valë edhe të votimeve shpeshherë që kemi qenë. Ju faleminderit dhe respektim të plotë të këtij vendimi. Kërkoj mirëkuptimin edhe të këshilltarëve”, pohoi kryesuesi Ibishi.

Ndue Shabanaj, tha se edhe unë ndoshta kam pasur arsye për ta bërë një deklaratë para kësaj kohe, por megjithatë nuk e kam shfrytëzuar këtë arsye. “Dëshiroj vetëm për njoftim se unë kohë më parë kam kaluar në PSHDK, dhe nuk kam dashur për të ndërruar asgjë edhe nga sigla, edhe nga përfaqësimi, edhe nga marrëveshja që kemi pasur paraprakisht si IPK, edhe tani e tutje me që unë në këtë AK për këtë mandat kam qenë me vota të anëtarësisë të subjektit politik Iniciativa për progresin e Klinës, mu ka dukur korrekte për ta vazhduar mandatin kështu. Kështu kam vepruar më herët edhe tash gjithashtu. Çështja e kalimit në subjekte të ndryshme politike është çështje e vullnetit të lirë, është çështje e përcaktimeve individuale, por unë falënderoj të gjithë kolegët edhe për mirëkuptimin, edhe për angazhimin e përbashkët, edhe për qasjen tonë jo gjithmonë mbi baza të përkatësisë politike, por unë them shpeshherë dhe më shpesh, mbi baza të interesit të qytetarëve të komunës së Klinës. Kështu kemi bërë përpjekje për të pasur qasjen që nga fillimi, unë vazhdoj për ta pasur të njëjtën qasje pavarësisht ku jam dhe pavarësisht çfarë subjekti politik do t'i takoj. Ju faleminderit të gjithë dhe ju dëshiroj të gjithëve suksese dhe gjithë të mirat!”, ka konstatuar profesor Shabanaj.

Haxhi Ibishi, shprehu falënderimin e veçantë për punën e përbashkët gjatë këtij mandati katërvjeçar.

Fadil Gashi, tha se Violeta është kthyer në bazë, me Ndue Shabanin kam kënaqësi që kam punuar gjatë dhe kemi punuar në mënyrë mjaft korrekte. “Unë ju dëshiroj të dyve suksese dhe avancime të mëtutjeshme, personalisht këtyre dyve, edhe familjeve të tyre, dhe gjithsesi krejt anëtarëve të KK që jemi bashkë”, tha anëtari Gashi.

Pika e tretë: Shqyrtimi paraprak i buxhetit dhe projekteve të Komunës për vitin 2017.

Haxhi Ibishi, tha se ju e dini që janë organizuar debate në nivel të BL-ve, në disa lokalitete, por edhe këtu në nivel qyteti, nuk ka qenë përfshirja, duhet të jem korrekt, përfshirja e qytetarëve e kënaqshme sa kishim pasur dëshirë, por megjithatë ata që kanë qenë me respekt të veçantë, kanë dhënë kontributin e tyre. Ne për këtë seancë në qoftë se dikush prej ekzekutivit, Bakia ose Enveri na kishin dhënë ndonjë sugjerim rreth kësaj çështje do të kishte qenë mirë. Kemi edhe një debat që do të bëhet edhe me publikun, do të jetë edhe debati përfundimtar nëpër dy instanca tona vendimmarrëse, edhe në KPF, edhe në AK të shtatorit për vendimmarrje definitive për buxhetin e vitit 2017. Nëse ka ndokush rreth materialit janë ekzekutivi këtu dhe mund të na sqarojnë”, shtoi kryesuesi Ibishi.

Nuk pati debate rreth çështjes në shqyrtim.

Haxhi Ibishi, tha se le të mbetet që në shtator, le të përpunojmë edhe ekzekutivi, edhe ne në debatin me publikun, pastaj në seancën e shtatorit marrim vendimin.

Fadil Gashi, tha se kisha kërkuar bashkërisht që në këtë periudhë sa ka mbetur deri në shtator, është mirë që ekzekutivi, edhe ju si kryesues, po që doni për të involvuar edhe KPF-në, edhe një herë le të tentojnë për të mbajtur takime me qytetarët. Unë po shoh nëpër komuna tjera, për aq sa keni mundësi, sepse ndoshta i përafroji edhe më shumë kërkesat dhe nevojat e tyre”, shtoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, sqaroi se kemi edhe një debat me publikun mbi varrezat dhe ceremonitë, edhe mund ta shfrytëzojmë, po them me dakordancën e të gjithëve dhe faktorëve relevantë, edhe të ekzekutivit, edhe të grupeve parlamentare, që për ta futur edhe si pikë diskutimi në atë debat me publikun të mos bëjmë edhe dy herë, pra që të jetë si pikë shtesë në debatin me publikun”, tha kryesuesi, i cili vazhdoi: “I mbetet ekzekutivit bashkë mua, me grupet parlamentare, edhe KPF, edhe të organizojmë një debat me qytetarët për buxhetin”, tha kryesuesi Ibishi.

Pika e katërt: Shqyrtimi i propozimit për vendosje të panos së anëtarëve të Kuvendit Komunal në sallën e KK.

Haxhi Ibishi, tha se një dakordancë që kemi pasur me të gjithë shefat e GP, pastaj KPF, kemi ardhur te një konkludim që është kulturë demokratike, është kujtesë historike, është obligim për gjeneratat që vijnë, që në secilin institucion të Republikës së Kosovës, qoftë në nivelin lokal, qoftë në nivelin qendror, të lë gjurmë të veprimtarisë së vet, pavarësisht divergjencave momentale, pavarësisht pozitë-opozitë, kush ka udhëhequr në vite. “Dhe ka qenë një dakordancë e gjithë neve që të ketë një vendim, i cili thjesht, obligon këtë përbërje, por edhe përbërjet e ardhshme, të jetë një kulturë demokratike në kujtim, gjithmonë të asamblistëve, të organit më të lartë të KK, që njerëzit që donë për t’u marrë me të kaluarën shohin se vendimet e caktuara, në periudhën e caktuar, kush janë ata njerëz që kanë marrë në të mirën e qytetarëve të Klinës. Prandaj unë kisha bartur fjalën të secili shef i grupit parlamentar. Kështu e kemi konceptuar për të dhënë deklarinimin e tyre për këtë propozim”, theksoi kryesuesi.

Ramush Agush (PDK), tha se ne kemi marrë një vendim në KPF, jemi dakorduar, e dhe unë e mbështes atë vendim që kemi marrë në KPF.

Arben Limani (LDK), edhe ne si grup i asamblistëve të LDK-së e mbështesim iniciativën për vendosjen e panos të anëtarëve të KK, pasi konsiderojmë se i shërben edhe historisë së këtij Kuvendi prej pasluftës, edhe mendoj që është ide e qëlluar, edhe ide e qëlluar”, ka thënë anëtarui Limani.

Tuna Dedaj, (AAK), tha se edhe ne si AAK e mbështesim këtë iniciativë, edhe vlerësojmë se është shumë e qëlluar.

Ndue Shabanaj (IPK), tha se edhe ne e mbështesim, e kemi vlerësuar dhe e vlerësojmë si mjaft të qëlluar. “Është momenti që ta hedhim një shikim drejt së kaluarës për ta parë edhe të ardhmen, më mirë dhe më të ndritshme. Unë besoj se e ka arsyen e plotë kjo. Mirë është për këtë përbërje të AK, që jemi marrë vesh edhe me herët me shefat e GP, por edhe gjitha legjislaturat për të pasur së paku emrat dhe për t’u ditur një historik sado që është i shkurtër, por është një fillim, unë e them i mbarë, i cili duhet të përcjellët pavarësisht kush do të jetë kryesues, përkatësisht kush do të vazhdon me udhëheqje të AK. Unë e përshëndes për zemërsisht edhe është mirë për ta filluar një iniciativë të tillë dhe përgëzoj për iniciativën”, ka konstatuar prof. Shabanaj.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

Me vota unanime (18) u miratua vendimi për vendosjen e panove të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në sallën e Kuvendit.

Pika e pestë: Të ndryshme.

Haxhi Ibishi, theksoi se do të jetë shumë korrektësi që në këtë kohë të parapërgatitjes së fushatës paraelektorale kuvendi ta ruajë nivelin që ka pasur, edhe thjeshtë të mos degjenerojë shumë me deklarime politike që prishin atmosferën që kemi kryesuar.

Tunë Dedaj, tha se kjo nuk është për fushatë, se kam ndërmend këtë diskutim të shfrytëzoj për fushatë. “Unë shprehi një shqetësim para gjithë juve, banorëve të fshatit tim, fshatit Deiq, që 9 muaj Hidrodrini nga ka hequr pompën e ujët e na ka lënë pa ujë të pijshëm. Ja kam thënë kryetarit, e kam thënë në këtë Kuvend, edhe më herët kur nuk ka qenë kohë fushate. Nuk e di qysh ka mundësi për të shkuar në atë mënyrë, pa i thirrur askush në përgjegjësi për këtë punë që kanë bërë. Kryetarin kam njoftuar, më ka premtuar se do ta thërras drejtorin e Hidrodrinit për të biseduar me këtë problematikë, nuk e ka thirrur. Neve nuk na mbetët asgjë tjetër ose të dalim në rrugë ta bllokojmë rrugën, ose të qesim në gjykatë. Një zgjidhje tjetër nuk po shohim. Puna e Hidrodrinit është zi e terr, të thuhet zero është kah plusi, mirëpo është nën zero. Po ju njoftoj, unë bie asaj rruge shpesh, e kemi njoftuar, tri javë ditë ka dalë ujët në rrugë sa qesin tri pompa të ujët bukur të mëdha, tri javë nuk ka shkuar askush ëpr të sanuar atë defekt. Punëtori i Hidrodrinit nuk e ka shtëpinë më larg se 200 metra, që ka vërejtur shumë mirë këtë avari. Ky është shqetësim. Prapë po ju them, mos e merrni se nuk e kam për fushatë, mirëpo është mirë që dikush ta nge zërin”, ka konstatuar anëtari Dedaj.

Haxhi Ibishi, tha se ju përshëndes të gjithëve dhe shihemi në seancën e shtatorit.

Kryesuesi seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 11:00.

Procesmbajtësi,
Mikël GOJANI

Kryesuesi i KK,
Dr. Haxhi IBISHI